

AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI I SHOQËRISË “Photodaf Creative” SHPK

THEMELIMI

Neni 1

Ortaket themelues

- 1.1 Shoqëria “**Photodaf Creative**” SH.P.K. themelohet nga Ortaket:
Z.Fiorelo Daupi, shtetas shqiptar, lindur më 19.09.1992 ne Durres, Shqiperi, rezident ne Modena, Itali, mbajtes i Pasaportes me Nr.personal J20919072O me zotesi te plote per te vepruar
Z.Arben Daupi, shtetas shqiptar, lindur më 24.05.1962 ne Durres, Shqiperi, rezident ne Modena, Itali, mbajtes i Pasaportes me Nr.personal G20524043L me zotesi te plote per te vepruar
Z.Anxhelo Daupi, shtetas shqiptar, lindur më 14.10.1994 ne Durres, Shqiperi, rezident ne Modena, Itali, mbajtes i Pasaportes me Nr.personal J41014067W me zotesi te plote per te vepruar

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2

Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është “**Photodaf Creative**” SH.P.K.

Neni 3

Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5

Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).
5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

Neni 6

Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. Besim Alla, Pallati Alfa, Hyrja 4, Zyra nr.14, Yzberisht, Tirane
- 6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 7

Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemët dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnjë emblemën dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: Laborator, Foto, video, evenete
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 9

Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 ALL (Njeqind mijë ALL).
- 9.2 Kapitali ndahet në 3 (tre) pjesë.
 - Ortaku themelues **Z. Fiorelo Daupi** zoterues i një kuote me vlerë te pergjithshme 40000 ALL qe perben 40% te kapitalit
 - Ortaku themelues **Z. Arben Daupi** zoterues i një kuote me vlerë te pergjithshme 30000 ALL qe perben 30% te kapitalit
 - Ortaku themelues **Z. Angelo Daupi** zoterues i një kuote me vlerë te pergjithshme 30000 ALL qe perben 30% te kapitalit
- 9.3 Pjesa e kapitalit zotërohen 100% nga Ortaket.
- 9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet.

- 10.1 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblese se Ortakeve.

Neni 11
Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Ortakeve.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 12
Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas proçedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marries së vendimit nga Asambleja e Ortakeve te shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Ortakeve reportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13
Vendimet e ortakut të vetëm

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren prej Asamblese se Ortakeve.
- 13.2 Vendimet e Asamblese se Ortakeve përfshijnë kryesisht:
 - Ndryshimin e selisë ose të emërtimit të shoqërisë;
 - Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
 - Prishjen dhe likujdimin e shoqërisë;
 - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
 - Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
 - Miratimin e bilancit të shoqërisë;
 - Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.

Neni 14
Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Ortakeve.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.

- 14.3 Administratori i shoqërisë eshte **Z.Egit Duka**, shtetas shqiptar, lindur më 01.04.1999, ne Durres, rezident ne Durres, mbajtes i Kartes ID me Nr. Personal J90401071A me zotesi te plote per te vepruar
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
 - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
 - Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitacione apo entitete publike ose private,
 - Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
 - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit;
 - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë,
 - Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet, te hape dege ose zyre perfaqësimi, që konsiderohen te nevojshëm për biznesin e shoqërisë.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 15 Viti finanziar

- 15.1 Viti finanziar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përashtim, viti i parë finanziar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16 Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asamblese se Ortakeve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të viti pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda viti.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si

garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 17

Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të per gjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18

Likujdimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese se Ortakeve.
- 18.2 Me vendimin e Asamblese se Ortakeve caktohet një likujdator ose një grup likujdatorësh që do të plotësojnë procedurat e likujdimit.
- 18.3 Likujdatori do të përgatisë raportin e likujdimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likujdimit dhe kohën që nevojitet përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Ortakeve do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likujdimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 07.06.2021

ORTAKET:

Egit Daipi


Z.Fiorelo Daipi
Z.Arben Daipi
Z.Anxhelo Daipi


D.J.
D.J.
D.J.